



Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit Universitar "Biznesi" në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit Universitar "Biznesi" më 14. 07. 2010 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR POLITIKAT, KRITERET DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT TË KOMPJUTERËVE DHE RRJETIT

Me këtë Rregullore, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Kolegjit Universitar "Biznesi", përcaktohen politikat, kushtet dhe mënyra e përdorimit të kompjuterëve dhe rrjetit (informativ-teknologjik) brenda KU "Biznesi".

Kur pjesëtarëve të KU "Biznesi" u jepet e drejta për të punuar në një sistem kompjuteri ose rrjet kompjuteri në përdorim të përbashkët, ata bëhen pjesë të bashkësisë së përdoruesve.

Politika e KU "Biznesi" për përdorimin e kompjuterit dhe të rrjetit zbatohet për të gjithë përdoruesit e kompjuterëve dhe të burimeve të rrjetit të KU "Biznesi". Gjithashtu, mund të zbatohen politika shtesë për sisteme specifike nga organet përkatëse të KU "Biznesi".

1. Përdorimi i kompjuterit dhe i rrjetit

1.1 Përdorimi individual

Numri i llogarisë së anëtarësisë dhe lidhjet e rrjetit (qoftë nëpërmjet Qendrës së Kompjuterëve ose një zyre të Kolegjit) janë për përdorim individual. Një numër llogarie kompjuteri duhet të përdoret vetëm nga personi të cilit i është caktuar. Të gjithë anëtarët janë përgjegjës për të gjitha veprimet që zënë fill nëpërmjet llogarive të tyre ose të lidhjeve në rrjet. Ata nuk duhet të paraqiten si persona të tjerë, të keqparaqesin ose të fshehin identitetin e tyre në veprimet dhe në mesazhet elektronike.

1.2 Respektimi i privatësisë dhe i sigurisë së përdoruesve dhe të sistemeve

Me përjashtim të rastit kur informacioni posaçërisht bëhet publik ose i gjetshtëm për një anëtar, ai anëtar duhet të pranojë se gjithçka tjetër në rrjet është private. Anëtarët të cilët mund të kenë aftësinë që nëpërmjet një rrugëdaljeje, nga pakujdesia e dikujt etj., do të hyjnë në dosje, në regjistra ose në informacione që nuk u përkasin atyre, ata anëtarë nuk kanë të drejtë të veprojnë në këtë mënyrë. Është e ndaluar çfarëdo përpjekjeje për t'i dredhuar sigurisë së kompjuterit, të rrjetit ose të dosjes, apo që të përfitohet nga gabimet e sigurimit.

1.3 Përdorimi i e-mailit

Komunikimi me e-mail paraqet komunikimin zyrtar brenda KU "Biznesi".

Anëtarët, respektivisht personat, obligohen që rregullisht të lexojnë e-mailat. Kolegji mban të drejtën që t'i fshijë e-mailat e palexuar të cilët presin në server më tepër se një javë.

1.4 Shqetësimi i përdoruesve të tjerë ose shpërdorimi i burimeve të kompjuterit
Ndalohen rreptësisht veprimet dëmtuese ose/dhe ndërhyrëse, duke përdorur sistemet dhe rrjetet e kompjuterit. Ndër shembuj të tillë hyjnë, por nuk kufizohen vetëm me këta, viruset, kërcënimi ose rrezikimi i mesazheve, 'tejkalimi*', thithja e paketës (packet sniffing), programet me vetëpërsëritje, vëllimi i tepruar i transferimit të dosjeve, trafikimi ose printimi në rrjet dhe programe të tjera, dosje, harduere, softuere ose veprime, që me qëllim ose pa dashur e dëmtojnë ose e prishin sistemin a funksionimin e rrjetit, e komprometojnë a i dredhojnë sigurisë së sistemit ose të rrjetit, apo ndërhyjnë në punët e të tjerëve. Për shkak të veprimit të dëmshëm mbi sistemet dhe rrjetet tona, ndalohet shprehimisht dërgimi i letrave zinxhir dhe i mesazheve të ngjashme me e-mail 'kalo'.

1.5 Respekti për pronësinë intelektuale
Respekti për punën dhe krijimtarinë intelektuale është me rëndësi jetike për aftësinë sipërmarrëse dhe ligjëratën akademike. Ky parim zbatohet për veprat e gjithë autorëve dhe botuesve në të gjitha mediat. Ai përfshin respektin për të drejtën e njohjes, të drejtën e privatësisë dhe të drejtën për të përcaktuar formën, mënyrën dhe kushtet e botimit e të përhapjes. Për shkak se informacioni elektronik mund të fshihet dhe të riprodhohet me lehtësi, ka veçanërisht rëndësi kritike respekti për punën dhe shprehjen personale të tjerëve në mjediset kompjuterike. Mbajtësit të llogarisë i bie barra e provës për pronësinë ose për marrjen e lejes për të drejtën e autorit nga mbajtësi i saj. Me marrjen e një njoftimi përkatës, siç përcaktohet me ligj, për një veprimtari të mundshme keqbërëse, ne atje ku do të jetë e mundur do ta heqim ose do ta bllokojmë hyrjen në materialin përkatës. Njoftimet për shkeljet e përsëritura të së drejtës së autorit do të shkaktojnë mbylljen e shërbimeve të kompjuterit/rrjetit dhe/ose të veprimeve të tjera të KU "Biznesi".

1.6 Hyrja në numrat e llogarisë së kompjuterit dhe rrjeteve/Përdorim vetëm jotregtar

KU "Biznesi" do të bëjë përpjekje të arsyeshme që t'i ketë sistemet e veta të kompjuterit dhe rrjetet në përdorim gjithë kohën. Megjithatë, si pjesë e mbajtjes së rregullt ose veprimtarive të tjera të ndërmarra nga telekomunikacionet ose furnizuesit tjerë jashtë kontrollit të KU "Biznesi", sistemet dhe rrjetet mund të jenë jashtë përdorimit në çfarëdo kohe të veçantë. Kolegji ruan të drejtën për ta kufizuar ose mbyllur hyrjen në kompjuter dhe në burimet e rrjetit sipas nevojës. Sistemet e kompjuterit dhe rrjetet e KU "Biznesi" janë për përdorim individual joprofitabil, lidhur me misionin arsimor të KU "Biznesi", nga departamentet e tij, personeli dhe studentët, si dhe për veprimtaritë e biznesit të miratuara nga Kolegji.

1.7 Zbatimi i rregullave; respektimi i ligjit

Të gjithë përdoruesit duhet t'u përmbahen dispozitave të ligjeve të Kosovës, lidhur me përdorimin e kompjuterëve, telekomunikacionit, të drejtat e pronësisë intelektuale, mbrojtjen e të dhënave dhe çështjet tjera relevante. Këto ligje duhet të respektohen nga të gjithë përdoruesit. Mosrespektimi i ligjeve të tilla nuk do të pranohet si arsyetim për asnjë aktivitet joligjor. Të gjithë përdoruesit duhet t'u përmbahen politikave dhe rregullave të KU "Biznesi".

1.8 Privatësia

Kolegji do të ndërmarrë hapa të arsyeshme për të siguruar që dosjet dhe e-mail mesazhet të përdoruesit të mbeten private dhe, sipas politikës, nuk do të bëjë mbikëqyrjen e zakonshme të përmbajtjes të dosjeve ose të mesazheve të përdoruesit. Megjithatë, për shkak të natyrës së kompjuterëve dhe të komunikimeve elektronike, Kolegji nuk mund të garantojë privatësinë absolute të dosjeve dhe të informacionit të përdoruesit. Përdoruesit duhen të marrin masa paraprake të arsyeshme dhe ta kuptojnë se ka një rrezik, që në disa rrethana të tjerë njerëz, me qëllim ose pa dashje, mund të hyjnë në dosjet ose në mesazhet. Kur do të duket se janë në rrezik integriteti, siguria ose funksionalizmi i kompjuterëve ose i burimeve të rrjetit të KU "Biznesi" ose në rastet e shpërdorimit të politikave, kodeve ose rregullave dhe ligjeve të Kosovës, Kolegji ruan të drejtën të ndërmarrë çfarëdo veprimesh që i quan të nevojshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar me mbikëqyrjen e veprimtarisë, edhe shikimin e dosjeve) për të hetuar dhe zgjidhur situatën.

1.9 Kufizimet

Kolegji mund të vendosë kufizime për përdorimin e sistemeve të veta të kompjuteri dhe të rrjetit dhe/ose të ndërmarrë veprime plotësuese si përgjigje për ankesat, që japin dëshmi për shkeljen e kësaj politike ose të tjerave të KU "Biznesi" apo të kodeve ose të ligjeve të Kosovës.

2. Përmbajtja e sistemeve të informimit

2.1 Kolegji ruan të drejtën për të hequr çfarëdo material nga sistemi. Palët përgjegjëse do të njoftohen në një rast të tillë. Sponsorët dhe furnizuesit e informacionit janë përgjegjës për të garantuar që informacioni i tyre përputhet me standardet e mëposhtme.

2.2 Çfarëdo informacioni që vendoset në intranetin ose në uebfaqen e KU "Biznesi" duhet të jetë i përshtatshëm për përhapjen si në bashkësinë e qytezës ashtu, mundësisht, edhe në pjesën tjetër të botës.

- (i) Disa shembuj për materialin e përshtatshëm janë:
 - kalendarët ose shpalljet për ngjarjet që do të ndodhin;
 - përshkrimet e shërbimeve që ofrohen;
 - përshkrime dhe afate të kurseve.
- (ii) Disa shembuj të materialeve që do të quhen të papërshtatshme:
 - reklama tregtare, marka ose emblema me përjashtim të atyre që përdoren për të njohur sponsorizimin, për të

mbështetur misionin akademik të KU "Biznesi" ose për të propaganduar një shërbim biznesi që e ofron Kolegji;
- material që është i paligjshëm;
- informacion konfidencial.

2.3 Materialet duhet të kontrollohen që të jenë të përpikta dhe duhen përditësuar rregullisht.

2.4 Materiali me të drejtë autori nuk duhet futur pa lejen e mbajtësit të së drejtës së autorit.

2.5 Kolegji ruan të drejtën për të rregulluar paraqitjen e faqes me qëllim që të mënjanohet ngatërrimi ose dyzimi me faqet zyrtare. Secili dokument duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- emrin e furnizuesit, të organizatës dhe e-mail adresën
- autorin e dokumentit (nëse është i ndryshëm nga furnizuesi);
- datën e rishikimit të fundit të dokumentit;
- çfarëdo problemi të njohur lidhur me informacionin.

3. Njoftimi i shkeljeve

3.1 Nëse përdoruesi i rrjetit në çfarëdo mënyre njoftohet se janë bërë shkelje të politikave, kushteve dhe mënyra e përdorimit të kompjuterëve dhe rrjetit, ai përdorues duhet të njoftojë përgjegjësën e Qendrës së Kompjuterëve përkatësisht personat tjerë përgjegjës.

Ndërkaq për ndërhyrjet e subjekteve të tjerë jashtë KU "Biznesi" në sistemin e rrjetit të KU "Biznesi" do të iniciohen edhe veprime të tjera përkatëse në pajtim me ligjin (fletëdenoncime, fletëparaqitje etj.).



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dëkan